



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Data	
Nr. Prot	

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË MALLAKASTËR, ME KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË DREJTËSI INTEGRIM DHE UNITET”, ZHANETA SHEZAI HOXHAI

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Me shkresën nr. 3340 prot., datë 4.7.2023, këshilli i bashkisë Mallakastër, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Giola Kelment Lutaj, propozuar nga subjekti politik “Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet”.

Referuar nenit 164, paragrafi 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet, për këshillin e bashkisë Mallakastër, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 4, zj. Zhaneta Shezai Hoxhaj.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 17240 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Zhaneta Shezai Hoxhaj, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile si dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore për zj. Zhaneta Shezai Hoxhaj.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Zhaneta Shezai Hoxhaj, në këshillin e bashkisë Mallakastër, ku konstatohet se kandidati ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile, konkretisht ka ndryshuar rubrikën e mbiemrit nga “Nazeraj” në “Hoxhaj”.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Zhaneta Shezai Hoxhaj, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Zhaneta Shezai Hoxhaj, në këshillin e bashkisë Mallakastër, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

Valbona BALLGJINI - Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Majlinda ÇELMETA - Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

Ylli MERKAJ - Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË MALLAKASTËR, ME KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E "PARTISË DREJTËSI INTEGRIM DHE UNITET", ZJ. ZHANETA SHEZAI HOXHAI

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 3340 prot., datë 4.7.2023, këshilli i bashkisë Mallakastër, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Giola Kelment Lutaj, propozuar nga subjekti politik "Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet".

Referuar nenit 164, paragrafi 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet, për këshillin e bashkisë Mallakastër, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 4, zj. Zhaneta Shezai Hoxhaj.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Mallakastër, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet, zj. Zhaneta Shezai Hoxhaj

zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 17240 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Zhaneta Shezai Hoxhaj, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja "b" dhe pika 3, shkronja "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile si dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore për zj. Zhaneta Shezai Hoxhaj.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Zhaneta Shezai Hoxhaj, në këshillin e bashkisë Mallakastër, ku konstatohet se kandidati ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile, konkretisht ka ndryshuar rubrikën e mbiemrit nga "Nazeraj" në "Hoxhaj".

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Zhaneta Shezai Hoxhaj ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Zhaneta Shezai Hoxhaj, në këshillin e bashkisë Mallakastër, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mallakastër, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet, zj. Zhaneta Shezai Hoxhaj.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI